

Sinjalizime

Ekskluzive | Shtiu me armë në aheng në Han të Elezit, 22-vjeçari paraqitet vetë në Polici dhe dorëzon armën



Sinjali.com

23 Korrik 2026 08:37



Ka marrë zhvillim rasti i të shtënave me armë gjatë një ahengu familjar në Han të Elezit, pasi personi i dyshuar është paraqitur vetë në Polici dhe ka dorëzuar armën që dyshohet se ishte përdorur në incident, raporton Sinjali.

Sinjali mëson ekskluzivisht se bëhet fjalë për Musli Musliun rreth 22 vjeç.

Sipas burimeve të Sinjalit, rasti kishte ndodhur më 20 korrik, rreth orës 00:30, në restorantin “Oslo”, në rrugën “Lepenci” në Han të Elezit, ku ishte raportuar për të shtëna me armë gjatë një ahengu familjar.

Gjatë ekzaminimit të vendit të ngjarjes, hetuesit kishin gjetur 11 gëzhoja të kalibrit 9 mm të një arme me gaz, ndërsa rasti ishte iniciuar për veprat penale “Mbajtje në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve” dhe “Përdorim i armës ose mjetit të rrezikshëm”.

Burimet e Sinjalit bëjnë të ditur se më 22 korrik, rreth orës 12:45, Musli Musliu është paraqitur në Stacionin Policor në Han të Elezit, ku në mënyrë vullnetare ka dorëzuar një armë me gaz të tipit “EKOL MAJOR”, së bashku me një karikator të zbrazët.

Arma është sekuestruar nga hetuesit si provë materiale, ndërsa i dyshuari është intervistuar në prani të procedurave ligjore.

Me urdhër të Prokurorit të Shtetit, Musli Musliu është liruar në procedurë të rregullt, ndërsa hetimet për rastin vazhdojnë.

Shënim: Personat e apostrofuar në këtë artikull prezumohen të pafajshëm derisa fajësia e tyre të mos provohet me vendim të formës së prerë nga gjykata.

Sinjali – aty ku e vërteta flet para lajmit!

/GazetaSinjali/

Armë

Han të Elezit

Polici

Të tjera:




Vëllai i policit Shaban Hajdari me fjalë rrëqethëse: “Ah bre Shaban”

Kosovë



“Kujtimet do të mbeten të gjalla gjithmonë për ty”, mësuesja me dedikim prekës për...

Kosovë



Reagon shoku i policit të ndjerë: Humbëm një shok të mirë, një njeri me vlera dhe një polic të...

Kosovë



Ky është polici i Kosovës që u gjet i vdekur në Morinë

Siguri



E dashura e denoncoi se e rrihte, 27-vjeçari përfundon në Polici për dhunë në familje

Sinjalizime



U ndal për kontroll rutinë në Skenderaj, një detaj në veturë e çoi 48-vjeçarin në Polici

Sinjalizime



Ekskluzive | Babai dorëzon në Polici pistoletën që dyshohet se djali ia drejtoi në bal...

Ekskluzive



Ekskluzive | “Sikur ta kisha armën, e kisha vra” – kërcënohet zyrtari policor në Vushtrri, i...

Sinjalizime

Sinjali

Gazeta Sinjali mirëmbahet nga kompania "Sinjali" sh.p.k. Materialet dhe informacionet e Gazetës Sinjali nuk mund të kopjohen, të shtypen, ose të përdoren në çfarëdo forme tjetër, pa leje nga redaksia.



Lajme

Zgjedhjet 2026
Kosovë
Shqipëri
Rajon
Diasporë
Evropë
Botë

Aktualitet

Politikë
Drejtësi
Siguri
Shëndetësi
Arsim
Sociale

Hulumtime

Ekskluzive
Profile
Skandaloze

Ekonomi

Prodhime Vendore
Financa
Biznes

Sport

Botërori 2026
Futboll
Basketboll
Sporte Luftarake
Sporte të tjera

Showbiz

Bota e Yjeve
Modë & Stil
Bukuri dhe kujdes
Të tjera

OP-ED

Analizë
Kolumne
Intervistë

Jetë

Fitness
Ushqime
Travel
Këshilla
Receta
Dieta
Shëndeti

Kulturë

Film
Muzikë
TV & Radio
Libra
Art & Dizajn
Fotografi
Histori

Tech & Auto

Teknologji
Automjete
Telefona
Internet
Lojëra
Aplikacione

Fun

Qesharake
Kuriozitete
Kuize
Fakte
Të tjera